


2013

Strategjia për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje të Qytetarëve në proceset e vendimmarjes

2013-2016

Komuna e Vushtrrisë



Grupi punues komunal:

Blerim Zhabari, kryesues i grupit punues

Bahri Bivolaku, anëtar i grupit punues

Gazmend Morina, anëtar i grupit punues

Grupi mbështetës nga USAID/DEMI:

Besim Kurti, këshilltar Regjional për Qeverisje Lokale

Blerim Çerkini, specialist për Monitorim dhe Raportim

Hanife Limani, eksperte për Pjesëmarrje të Qytetarëve

Melihate Limani, udhëheqëse e Njesisë për Pjesëmarrje të Qytetarëve

Kryzstof Schuma, këshilltar i lartë për Qeverisje Lokale

Lekturoi në Gjuhën Shqipe:

Vlora Krasniqi

Përkthyer në Anglisht/Serbisht:

Bajram Pireva, USAID DEMI

Xxxx, USAID DEMI

PËRMBAJTJA

FJALA E KRYETARIT	3
PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT	4
LISTA E AKRONIMEVE DHE FIGURAVE	5
I. HYRJE.....	6
II. METODOLOGJIA.....	8
III. VLERËSIMI I GJENDJES AKTUALE.....	9
3.1 VLERËSIMI I MEKANIZMAVE AKTUAL	9
3.2 PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE TË ANKETIMIT	11
3.3 ANALIZA SWOT.....	Error! Bookmark not defined.
3.4 HARTA E KOMUNËS SË VUSHTRRIË	15
IV. VIZIONI	15
4.1 SKEMA.....	16
V. OBJEKTIVAT DHE PROJEKTET.....	17
5.1 OBJEKTIVA 1: AVANCIMI I OFRIMIT TË INFORMACIONIT PUBLIK PËR QYTETARËT.....	17
5.2 OBJEKTIVA 2: KRIJIMI I MUNDËSIVE PËR KOMUNIKIM/NDIKIM NË POLITIKAT PUBLIKE ...	21
5.3 OBJEKTIVA 3: KRIJIMI I MJEDISIT TË PËRSHTATSHËM PËR PJESËMARRJE AKTIVE	24
VI. PLANET E IMPLEMENTIMIT DHE BUXHETI	27
6.1 PLANI DINAMIK	27
6.1 PLANI I MONITORIMIT	Error! Bookmark not defined.
6.2 BUXHETI	30
ANEKS 2: ANKETIMI ME QYTETARË	31



FJALA E KRYETARIT

Të nderuar qytetarë të Komunës së Vushtrrisë, kam kënaqësinë t'ju prezantoj Strategjinë për informim, komunikim dhe pjesëmarrje të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë. Vushtrria ka kohë që ka dhënë dëshmi që e ka tejkaluar fazën e miturisë institucionale dhe tani ajo vazhdon që konsensusin e qeverisë lokale ta bëjë mbi qëndrimin politik në raport me interesin qytetar. Debatimi dhe mbështetja në realizimin të projekteve kapitale të interesit qytetar, bën që politika të zbresë nga lartësia dhe abstraktja dhe të merret me jetën e qytetarëve në

lagje, fshat dhe qytet, ndërsa mendimi politik të ketë koloritin për këto çështje. Vizioni im ka qenë gjithëherë në ngritjen e efikasitetit të punës së administratës komunale.

Dinamika e zhvillimit institucional dhe e shoqërisë nënkupton reforma të vazhdueshme për të qenë në shërbim të qytetarëve. Strategjia Komunale për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje të Qytetarëve 2013-2016 e punuar me përkushtim nga grupi punues i Komunës së Vushtrrisë dhe i mbështetur nga ekspertë të USAID-DEMI, i shërben këtij vizioni për t'i shndërruar mekanizmat institucional lokal përkatës si urë-lidhëse mes qytetarëve dhe pushtetit vendor. Komunikimi i jashtëm shkon përtej detyrimit ligjor. Një strategji dhe plan i mirë komunikimi përcakton dialogun mes komunës dhe qytetarëve, partnerëve, mediave e shoqërisë civile, donatorëve për prioritetet, projektet dhe pozicionin politik.

Ndërtimi i marrëdhënieve të mira me publikun do të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësimin e qeverisjes lokale, në përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të mbledhjes dhe përdorimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat lokale, në përdorim efektiv transparent të aseteve komunale, në krijim të një klime miqësore me biznesin, shoqërinë civile dhe mediat. Strategjia inkurajon qytetarët në përfshirjen e tyre në vendosjen e prioritetëve, në vlerësimin e nivelit të shërbimeve komunale dhe rritjen e transparencës në përdorimin e fondeve publike. Strategjia Komunale për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje të Qytetarëve, bashkë me planin veprues paraqet vullnetin e pushtetit lokal për të progresuar karshi dinamikës së zhvillimit të teknologjisë dhe i shërben përkufizimit dhe normimit të kësaj sfere për ta qarar tutje shkëmbimin, idetë, ndjenjat, perceptimet, mendimet dhe informacionin midis dërguesit e marrësit. Në emër të qytetarëve të komunës, të pushtetit lokal, falënderoj të gjithë ata që kontribuuan në hartimin e këtyre dokumenteve aq të rëndësishme për ne dhe qytetarët.

Me respekt,

Bajram Mulaku
Kryetar i Komunës së Vushtrrisë

PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT

Ky dokument paraqet pesë (5) kapituj të Strategjisë për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje të Qytetarëve në proceset e vendimmarrjes në Komunën e Vushtrrisë. Strategjia definon mënyrën më efektive të shfrytëzimit dhe krijimit të mekanizmave për informim, komunikim dhe pjesëmarrje e cila do të kontribuojë në zhvillim dhe promovim të parimeve të demokracisë dhe qeverisjes së mirë.

Kapitulli 1 “Hyrje”, dokumenti paraqet synimet e strategjisë, duke sqaruar po ashtu kuptimin bazë të koncepteve themelore të informimit, komunikimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve të adoptuara, bazuar në kontestin lokal të Vushtrrisë. Ky kapitull, po ashtu sqaron parimet bazë mbi të cilat është hartuar kjo strategji.

Kapitulli 2 “Metodologjia”, dokumenti paraqet metodologjinë e hartimit të strategjisë, duke përshkruar procesin nëpër të cilin ka kaluar hartimi i këtij dokumenti e deri te aprovimi i saj. Këtu përfshihet mënyra e grumbullimit të informacioneve mbi vlerësimin e gjendjes aktuale, realizimin e anketës me qytetarë në tërë territorin e Komunës së Vushtrrisë dhe po ashtu konsultimin e grupeve të ndryshme brenda dhe jashtë institucionit të Komunës së Vushtrrisë.

Kapitulli 3 “Vlerësimi i gjendjes aktuale”, dokumenti paraqet vlerësimin e gjendjes aktuale të informimit, komunikimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në qeverisje lokale. Fillimisht, paraqitet analiza e vlerësimeve nga jashtë, kryesisht vlerësime të organizatave dhe donatorëve, **ndërsa më tutje** vazhdohet me një vlerësim nga grupi punues. Analiza SWOT paraqet përparësitë, dobësitë, mundësitë, kërcënimet dhe **rreziqet** në fushën e informimit, komunikimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Bazuar në vlerësimin e gjendjes aktuale tutje janë definuar dhe përcaktuar masat e nevojshme, të cilat duhet të ndërmerren për përmirësimin e gjendjes.

Kapitulli 4 “Vizioni”, dokumenti paraqet vizionin afatshkurtër të Komunës të Vushtrrisë, në mënyrë që të krijohet një kuptim i plotë i vizionit dhe të krijohet mundësia e vlerësimit në të ardhmen. Është bërë sqarimi i kuptimit të elementeve të vizionit dhe janë zhvilluar treguesit matës. Për më shumë, kjo pjesë paraqet edhe skemën e strategjisë duke përfshirë: Vizionin, Objektivat dhe Prioritetet e Strategjisë.

Kapitulli 5 “Objektivat dhe projektet e strategjisë”, dokumenti paraqet objektivat e planifikuara të cilat do të ndihmojnë në arritjen e Vizionit të Strategjisë. Në kuadër të objektivave janë të paraqitura prioritetet dhe masat të cilat duhet të ndërmerren në arritjen e objektivave. Po ashtu, janë zhvilluar projektet e veçanta të cilat përmbajnë një informatë bazike të implementimit të projektit, duke përfshirë afatet kohore, planifikimin e shpenzimeve, personat përgjegjës, përfituesit dhe rezultatet e pritura.

Në pjesën e “Anekseve” paraqitet një përmbledhje e metodologjisë së anketimit dhe rezultatet e anketimit, ndërsa në të paraqiten edhe detajet e personave të cilët kanë marrë pjesë në realizimin e anketimit dhe kanë dhënë kontributin e tyre në realizimin e anketimit.

LISTA E AKRONIME

GAP- Instituti për Studime të Avancuara

KK- Kuvendi Komunal

KPF- Komiteti për Politikë dhe Financa

USAID DEMI- Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive

ZKP- Zyra për Komunikim Publik e Komunës së Vushtrrisë

DRAFT / PARË

I. HYRJE

Komuna e Vushtrrisë synon ndërtimin e një strategjie të qëndrueshme të informimit, komunikimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Informimi dhe përfshirja sa më e madhe e qytetarëve në vendimmarrje, është një nga objektivat kryesore të Komunës së Vushtrrisë e cila do të ndihmojë jo vetëm në avancimin e transparencës komunale por edhe në planifikimin e politikave publike në interes të qytetarëve.

Strategjia e Informimit, Komunikimit dhe Pjesëmarrjes së Qytetarëve e Komunës së Vushtrrisë, është një **strategji vizionare** e cila para se gjithash vë në fokus qytetarin dhe bazohet në opinionin e tyre mbi mënyrat e ofrimit të informacionit dhe fushat të cilat qytetarët janë më të interesuar të informohen. Ajo, po ashtu fokusohet në rritjen e transparencës komunale përmes ofrimit efektiv të informacionit dhe avancimit të mjeteve të komunikimit me qëllim të marrjes së mendimit të qytetarit për çështje që ndikojnë në përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve. Për më shumë, kjo strategji ka për qëllim avancimin në metodat e pjesëmarrjes së qytetarit, duke u fokusuar në aplikimin e mënyrave mbi të cilat qytetarët i kanë identifikuar si më efektivet për ndikim në vendimmarrjen komunale.

Kjo strategji është produkt i një **procesi të hapur** i cili përfshin mendimin e qytetarëve përmes anketimit të tyre në tërë territorin e Komunës së Vushtrrisë dhe po ashtu përfshirjen e mendimit të grupeve të ndryshme të interesit, profesionistëve të lëmit të komunikimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve dhe mediave që operojnë në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Komuna e Vushtrrisë planifikon të ofrojë kushte të krijimit të një qeverisjeje të mirëfilltë lokale, me një shoqëri civile aktive e cila merr pjesë dhe përgjegjësi në avancimin e çështjeve komunale.

Kjo qasje e përcakton pjesëmarrjen e qytetarëve më shumë sesa kontesti tradicional që nënkupton të *qenurit transparent* dhe shpjegon *pjesëmarrjen e qytetarëve si një qasje e menaxhimit të prekshëm e cila çon në rezultate konkrete.*

Mënyra e tillë e adresimit të pjesëmarrjes së qytetarëve përfshin parimet e pjesëmarrjes së qytetarëve në tri nivele: **(1) njëkahore- dhënie e njëanshme e informatave ose (2) dykahore- komunikim i dyanshëm, por po ashtu mundëson nivelin e (3) tretë dhe më të sofistikuar të pjesëmarrjes së qytetarëve- partneritetin**, duke siguruar një përfshirje kuptimplote të qytetarëve në qeverisjen lokale.

Strategjia për informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje të Qytetarëve do të jetë:

E hapur: Komuna e Vushtrrisë synon të krijojë një strategji të hapur të komunikimit, informimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve. Një parim i tillë nënkupton se qëllimet dhe veprimet e komunës mbi hartimin dhe implementimin e kësaj strategjie do të jenë në dispozicion për publikun.

Gjithëpërfshirëse: Në hartimin e strategjisë janë marrë parasysh opinionet e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Vushtrri. Veprimet e kësaj strategjie janë bazuar në parimin gjithëpërfshirës i cili synon të ofrojë mundësi të barabarta të informimit, komunikimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Efektive: Komuna e Vushtrrisë përmes hartimit të strategjisë synon të krijojë një sistem efektiv të informimit, komunikimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve. Për këtë arsye para hartimit të kësaj strategjie është bërë analiza e nevojave të qytetarëve në lëmin e informimit, komunikimit dhe pjesëmarrjes dhe pastaj janë ndërtuar objektivat dhe masat. Po ashtu, edhe në fazën e implementimit Komuna e Vushtrrisë do përdor të gjitha resurset në arritjen e rezultateve konkrete.

Bashkëpunuese: Komuna e Vushtrrisë ka bashkëpunuar me grupe të qytetarëve në hartimin e kësaj strategjie. Me bashkëpunim nënkuptohet shkëmbimi i aktiviteteve, resurseve dhe përvojave në mes të komunës dhe grupeve të ndryshme të qytetarëve.

Hartimi dhe implementimi i kësaj strategjie do të ndihmojë në avancimin dhe informimin e qytetarëve, e cila do rezultojë në krijimin jo vetëm të qytetarit të informuar dhe aktiv, por ka edhe mundësi të dhënies së mendimit në çështje me rëndësi publike dhe hapësirë, në mënyrë që të bashkëpunojë me Komunën e Vushtrrisë në shfrytëzimin sa më efikas të resurseve lokale për përmirësim të gjendjes socio-ekonomike të tyre.

DRAFT / PAKË

II. METODOLOGJIA

Hartimi i kësaj strategjie është bërë në dy qasje. Qasje e parë është fokusuar në analizimin e modeleve ekzistuese brenda Komunës së Vushtrrisë në dhënien e informacionit, komunikimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset komunale. Një gjë e tillë është realizuar përmes një analize të brendshme të këtyre modeleve përmes grupit punues të hartimit të strategjisë.

Ndërkohë që qasja e dytë ishte marrja e drejtpërdrejtë e informacionit nga qytetarët mbi mënyrat e preferuara të informimit dhe komunikimit me zyrtarë komunal. Po ashtu, rëndësi e veçante i është kushtuar perceptimeve të qytetarëve mbi mënyrat e ndikimit në vendimmarrjen e qytetarëve, si dhe fushat të cilat qytetarët preferojnë të bashkëpunojnë dhe ndikojnë në vendimmarrjen komunale.

Perceptimi i opinionit të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë është marrë përmes realizimit të anketës me qytetarë në tërë territorin e Komunës së Vushtrrisë. Anketa me qytetarët e Komunës së Vushtrrisë është realizuar në 29 zona rurale dhe 4 zona urbane. Numri i përgjithshëm i të anketuarve ka përfshirë 388 respondent, në zonën rurale 207 (54%) dhe në zonën urbane 175 (46%). Margjina e gabimit parashihet 5% dhe njësia e besimit vlerësohet të jetë 95%. Me qëllim që të kemi një gjithpërfshirje të qytetarëve në procesin e anketimit, në zonat rurale është bërë shpërndarja e të anketuarve në bazë të numrit të banorëve që jetojnë në këto zona rurale.

Bazuar në analizën e perceptimit të qytetarëve dhe situatës aktuale të praktikave të informimit, komunikimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset komunale, janë identifikuar objektivat e strategjisë. Këto objektiva përmbajnë prioritetet dhe masat që do ndërmerren në avancimin e ofrimit të informacionit, komunikimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset komunale në Vushtrri.

Pas hartimit të draftit të parë të strategjisë, është organizuar një fokus-grup i cili ka dhënë kontributin e tij në plotësimin dhe ndryshimin e draftit të parë të strategjisë. Në mënyrë që kjo strategji e komunikimit të jetë sa më praktike dhe e lehtë për implementim, grupi punues ka përpiluar edhe planin dinamik të implementimit dhe po ashtu planin e monitorimit të implementimit të strategjisë.

Strategjia për informim dhe komunikim është dorëzuar në Kuvendin Komunal, ku para aprovimit është vënë në diskutim publik me qytetarët duke u bazuar në kërkesat ligjore të aprovimit të dokumenteve publike në nivelin lokal.

III. VLERËSIMI I GJENDJES AKTUALE

Në përgjithësi, përvoja e Komunës së Vushtrrisë në fushën e informimit, komunikimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve, është vlerësuar me transparencë të zhvilluar edhe nga aktorë të jashtëm jashtë qeveritar, duke përfshirë edhe ato ndërkombëtare.

Sipas këtyre vlerësimeve, Komuna e Vushtrrisë është komuna e cila ka vënë më së shumti dokumente në dispozicion të publikut përmes ueb faqes zyrtare.

Në raportin e monitorimit të komunave të Kosovës për vitin 2008, Ueb faqja e Komunës së Vushtrrisë (Ueb faqe e krijuar para standardizimit të Ueb faqeve të institucioneve publike nga Qeveria e Kosovës), vlerësohet si Ueb faqja me më së shumti informacione, e Komuna e Vushtrrisë ndër komunat më transparente.

Po ashtu për dy vite rresht, për 2010 dhe vitin 2011 Komuna e Vushtrrisë është vlerësuar nga MAPL dhe Programi i USAID/DEMI si komuna më transparente, ku edhe është shpërblyer dy herë me nga 25 mijë dollarë.

Po ashtu edhe për vitin 2012 një tjetër organizatë jashtë qeveritare, Instituti për Studime të Avancuara GAP, e vlerëson Ueb faqen e komunës me më së shumti informata dhe Vushtrrinë si komunën më transparente. "Nga të gjitha faqet zyrtare që kanë komunat e Kosovës, faqja zyrtare e komunës së Vushtrrisë mirëmbahet më së miri dhe në të gjenden shumëllojshmëri informatash të postuara", thuhet në vlerësimin e GAP-it që i bënë Komunës së Vushtrrisë, të publikuar në shtator 2012.

3.1 VLERËSIMI I MEKANIZMAVE AKTUAL

Komuna e Vushtrrisë ka krijuar një traditë në informim dhe komunikim me qytetarë. Në këtë aspekt, ajo ka krijuar Zyrën për Komunikim me Publikun (ZKP) e cila funksionon si zyre e veçantë pranë zyrës së kryetarit të komunës.

Kjo zyrë momentalisht ka dy të punësuar, zyrtarin për komunikim dhe një zyrtar në Zyrën e Informimit. Po ashtu, zëdhënësi i Komunës së Vushtrrisë është njëherit këshilltar i kryetarit për marrëdhënie me publikun dhe vazhdimisht bashkëpunon me ZKP dhe drejtoritë komunale, për të ofruar informacione tek publiku.

Komuna e Vushtrrisë dhe ZKP ka kohë që ka krijuar disa kanale të informimit, komunikimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve:

- 1) Mjetet e Informimit:
 - a) Web Faqja: Komuna e Vushtrrisë ka krijuar dhe mirëmban ueb faqen zyrtare të komunës që nga viti 2005, duke u mundësuar qasje më të lehtë qytetarëve në dokumentet dhe ngjarjet komunale. Postimi i vazhdueshëm i dokumenteve dhe informatave të rëndësishme e që janë në interes të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë, ka ngritur transparencën e organeve komunale. Vetëm gjatë vitit 2012 (janar – tetor 2012), në ueb faqja e komunës ka pas 31 838 klikime në ballinë, pa llogaritur qasjet

direkte në menytë tjera përmes linçeve që zyrtaret komunal i postojnë. Ndërkaq në vitin 2012 në Komunën e Vushtrrisë ka pas 176.894 klikime në gjithë Ueb faqen. Po ashtu gjatë 2012 kishte edhe 34.019 shkarkime të dokumenteve. Nga administrimi i të dhënave të Ueb faqes, vërehet se ka edhe një tendencë që ueb faqja të klikohet edhe nga vendet e Evropës Perëndimore ku jetojnë dhe punojnë shumë bashkëqytetarë tanë.

2) Rrjetet sociale:

- b) Facebook: Komuna e ka krijuar faqen e saj zyrtare në Facebook që nga viti 2011. Kjo faqe i ka 1968 shokë dhe janë postuar gjithsej 861 fotografi.
- c) Youtube: Në kuadër të web faqes komunale, nga viti 2011 e deri më tani në kanalën You Tube janë postuar 221 materiale dhe janë 100883 klikime.

3) Mediat e shkruara:

Aktivitetet dhe ngjarjet lokale mbulohen rregullisht nga mediumet e shkruara të cilat deri në vitin 2012 me qëllim të pasqyrimin të aktiviteteve ishin të angazhuar shumë korrespondentë në qytetin e Vushtrrisë. Cilësia dhe sasia e informatave që korrespondentët marrin nga ana e autoriteteve lokale vlerësohet përgjithësisht e kënaqshme.

4) Televizione:

Në Vushtrri nuk ka televizion lokal, ndërsa nga televizionet kombëtare ka përcjellje gjithsej të 184 ngjarjeve me një mesatare prej 400 minutave për vitin 2012.

5) Radio:

Në Komunën e Vushtrrisë funksionon radioja lokale- Radio "Vicianum" e cila angazhohet t'i mbulojë zhvillimet e përgjithshme në këtë komunë. Aktivitetet e komunës janë paraqitur 284 herë, duke përfshirë transmetimin e drejtpërdrejtë të të gjitha seancave të Kuvendit Komunal.

1) Mjetet e komunikimit:

- a) Ueb faqja: Për dallim nga ueb faqet e komunave tjera në ueb faqen e Komunës së Vushtrrisë është krijuar hapësira e caktuar, e titulluar "Këndi i opozitës" ku përfaqësuesit e subjekteve opozitare mund t'i shprehin komentet, sugjerimet dhe opinionet e tyre.
- b) Facebook: Komuna e Vushtrrisë u ofron mundësi qytetarëve për postimin e komenteve, opinionëve dhe sugjerimeve drejtpërdrejtë në faqen zyrtare të facebook.

2) Metodatat e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse në komunë:

a) Tubimet Publike:

Përveç dy takimeve të rregullta publike me qytetarë, gjatë vitit komuna mban edhe takime tjera me qytetarë sidomos në zonat rurale, qoftë edhe për çështje të veçanta të qytetarëve. Po ashtu është edhe koha e caktuar kur kryetari i komunës, kryesuesi i KK-së por edhe drejtorët kanë takime të veçanta me qytetarë.

- b) Dëgjimet Publike: Komuna në përkrahje edhe të partnerëve të saj, ka ndërtuar një sistem të konsultimit të publikut dhe dëgjimeve publike para hartimit të buxhetit. Në dëgjimet buxhetore për KAB 2013-2015, nga data 29 qershor deri më 24 gusht 2012 janë mbajtur gjithsej 11 takime me qytetarë (në qytet dhe viset rurale) me pjesëmarrje të 285 qytetarëve, në të cilat takime janë bërë 111 kërkesa-prioritete të investimeve, ndërsa në buxhetin e vitit 2013 janë përfshirë 23 kërkesa-prioritete të investimeve në infrastrukturë në vlerë prej 1.281.648.00 €, kurse kërkesat tjera të qytetarëve janë përfshirë në KAB për investime kapitale në vitin 2014 dhe 2015.

3) Partneriteti me qytetarët:

- a) Projektet që bashkë financohen me qytetarët:

Komuna e Vushtrrisë ka një dekadë që ka krijuar një përvojë të mirë në fushën e bashkëfinancimit të projekteve në partneritet me qytetarët, kryesisht në infrastrukturë dhe avansimin e bujqësisë. Komuna për çdo vit ka linja të veçanta buxhetore për bashkëfinancim të projekteve në partneritet me qytetarët, si në investime në përmirësimin e infrastrukturës ashtu edhe në krijimin e një ambienti në zhvillimin e bujqësisë. Për këtë qëllim (2013) janë alokuar 100,000 €, për bashkëfinancim me qytetarë, ku planifikohet që qytetarët të participojnë financiarisht në vlerë prej 15% të projektit.

3.2 PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE TË ANKETIMIT

Informacione të përgjithshme:

- Të anketuar: 388 qytetarë;
- Vendbanimi: 207 rural dhe 175 urban
- Struktura gjinore: 86 femra; 302 meshkuj;
- Struktura etnike: 366 shqiptarë; 21 serbë; 1 turk

Informimi:

- Rreth 53% e qytetarëve deklarohen të kënaqur me informacionet që ofrohen nga ana e komunës.
- Burimet përmes të cilave informohen qytetarët janë: TV/Radio kombëtare dhe Lokale (44.7%); Facebook (20.8%); ueb faqe(10%) Tjetër: Shoqërisë, nëpunësve civil në komunë etj. (13%);
- Ndërsa mënyrat e preferuara të marrjes së informacionit janë: Web Faqja e Komunës (25%); Facebook (21%); takime të drejtpërdrejta (17.5%); tabela të shpalljes (11.1%); buletin i komunës (5.7%); ndërkaq burime të jashtme TV/radio (14.9%) dhe gazeta (4.1%).
- Fushat në të cilat qytetarët dëshirojnë të informohen janë: Buxhet dhe Financa (28.9%); Arsim (16.8%); Investime Kapitale, Kulturë, Rini dhe Sport (16%); Shëndetësi (11.9%); Politikat Publike (5.7%).
- Anketuesit besojnë më shumë në informacionet që marrin nga televizionet nacionale (25.52%), tabelat e shpalljes (17.53%), radiot lokale (16.24%), ueb faqen komunale (15.21%), facebook (13.14%), publikime (5.15%) dhe radio nacionale (1.80%).

Komunikimi:

- Qytetarët komunikojnë me komunat mbi çështjet komunale përmes pjesëmarrjes në dëgjime publike (33.5%); takime me zyrtarë komunal (27.3%); shkresë dërguar në komunë (13.7%); e-mail dërguar në komunë (12.1%); facebook (11.3%).
- Qytetarët mendojnë se ndikojnë në vendimet komunale përmes takimeve zyrtare (37.7%); përmes pjesëmarrjes në dëgjime publike (34.1%); e-mail (4.7%) dhe forma tjera (8.9%).

Pjesëmarrja:

- Mbi 40.7% e qytetarëve deklarohen se nuk marrin pjesë në aktivitete të komunës, 23.2% e tyre marrin pjesë rrallë, ndërsa 26.3% marrin pjesë ndonjëherë dhe 9.8% marrin pjesë shpesh.
- Ndërkohë që qytetarët janë të gatshëm të bashkëpunojnë me komunën në përmirësimin e:
 - o Investimeve Kapitale (20%), prej të cilave kryesisht në rrugë dhe infrastrukturë (43.59%); hapësira gjelbëruese, parqe për fëmijë, hapësira sportive (8.97%); ujësjellës (2.56%); ndriçim publik (8.97%); ndërtesa dhe monumente historike (5.13%)
 - o Zhvillimit Ekonomik (27.3%), prej të cilave kryesisht në investime në bujqësi (34.91%) ku si prioritet është paraparë mbështetje në krijimin e fermave të lopëve (13.16%); projekte që gjenerojnë punësim (11.32%); mbështetje bizneseve (4.72%); ndërtim/infrastrukturë (5.66%)
 - o Arsimit (19.6%): prej të cilave kuadër arsimor (10.53%); ndërtimin e shkollave (23.68%); rritjen e cilësisë së arsimit (3.95%); laboratorë (2.63%); kopshte për fëmijë (1.32%); shkolla speciale (1.32%);
 - o Shëndetësisë (13.4%) prej të cilave kryesisht në përmirësimin e shërbimeve emergjente (11.54%); informim për shërbime shëndetësore në përgjithësi (5.77%); furnizim me aparate për kontrollime shëndetësore (9.62%);

DRAFT / PARÈ

<u>PËRPARËSITË</u>	<u>DOBËSITË</u>
<ul style="list-style-type: none"> • Komuna ka përvojë të konsiderueshme në informimin e qytetarëve (përvoja e fituar dhe vlerësimet e jashtme USAID 2010, 2011, Instituti GAP 2012.); • sistemi i zhvilluar i informuar përmes rrjeteve sociale (Website, Facebook, Youtube); • transparenca e zhvilluar; • Besueshmëria e qytetarëve për informatën e ofruar nga komuna; • funksionimi i këshillave të fshatrave dhe bashkësive lokale; • ndërtimi i sistemit të informimit dhe pjesëmarrja aktive e qytetarëve në manifestime publike dhe tradicionale, festivalet tradicionale, “Takimet e poeteshave shqiptare”, “Dita e patates”; • Qytetet i pasur me trashëgimi kulturore; 	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e mirënjohjes publike për qytetarët aktiv në fusha të ndryshme; • ndarja e fondeve të pamjaftueshme për informim dhe pjesëmarrje të qytetarëve; • përkushtimi jo i mjaftuar i OJQ-ve lidhur me fushën e informimit, komunikimit dhe pjesëmarrjen e qytetarëve; • qasja jo e duhur e komunës për plasim të informatave përmes ZKP (komunikimi i brendshëm, drejtoritë lidhur me aktivitetet javore, mujore..); • Sistemi jo në nivel të ndërtimit të komunikimit : kuvend-administratë- qytetarë-grupe të interesit • mjetet jo të mjaftueshme për një sistem të mirëfilltë të komunikimit (telefoni për qytetarët dhe ambiente pune); • Informacion jo i mjaftueshme për qytetarë rreth shërbimeve komunale; • mungesa e buletinit mujor; • mungesa e stendave informuese në vendet më të frekuentuara për plasim të informacioneve; • mosinteresimi i mjaftueshëm i qytetarëve për të drejtën në qasje në dokumente publike; • iniciativa e qytetarëve jo e zhvilluar; • mungesa e kalendarit vjetor informativ për aktivitetet kryesore të komunës; • niveli jo i mirë i komunikimit dhe bashkëpunimit në mes: këshilltarëve, qytetarë dhe OJQ-ve; • hapësira jo e volitshme dhe numri jo i mjaftuar në qendrën për shërbim për qytetarë
<u>MUNDËSITË</u>	<u>RREZIQET</u>
<ul style="list-style-type: none"> • përvoja dhe qasja profesionale në fushën e informimit, komunikimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse; • ndërtimi i koncensusit mes kuvendit dhe administratës për çështje që janë në interes të qytetarëve-komunikim dhe pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse; • Korniza ligjore e përshtatshme për informim, komunikim dhe pjesëmarrje të qytetarëve në proceset vendimmarrëse; • Ligji për qasje në dokumente publike; • gatishmëria e qytetarëve në ndërtimin e partneritetit me komunën, veçanërisht në sektorin e zhvillimit ekonomik, investimeve kapitale, arsim dhe shëndetësi. 	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e linjës buxhetore e burimeve financiare për një zhvillim të avansuar të sistemit të informimit, komunikimit me publikun; • zhvillimi ekonomik dhe mosbesimi në institucionet publike; • byrokracia dhe hezitimi për ndryshime nga personeli i administratës; • Perceptimi i opinionit publik rreth ekzistencës së korrupsionit në institucionet publike;

3.3 HARTA E KOMUNËS SË VUSHTRISË

Fig.1. Harta e Komunës së Vushtrrisë



IV. VIZIONI

Vizioni i strategjisë për informim, komunikim dhe pjesëmarrje të qytetarëve në procese vendimmarrëse është:

Komuna e Vushtrrisë në periudhë trevjeçare të ketë qytetarë të informuar, komunikues dhe pjesëmarrës aktiv në procese vendimmarrëse, me qëllim të përmirësimit të kualitetit të jetës.

Vizioni paraqet situatën në të cilën Komuna e Vushtrrisë dëshiron të arrijë pas një periudhe trevjeçare. Vizioni nuk është një deklaratë abstrakte. Përkundër faktit që është një fjali e përmbledhur, ai përmban një peshë të madhe dhe mbi të gjitha ka një qëllim që duhet të matet dhe të monitorohet në mënyrë periodike. Duke pas parasysh që është e vështirë të maten qëndrimet e përgjithshme, në vijim janë detajet e elementeve të ndryshëm të vizionit. Së bashku me indikatorët ato paraqesin një bazë në matjen e vizionit. Duke matur arritjen e vizionit, në të njëjtën kohë do matet edhe nivelin i përgjithshëm i informimit, komunikimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në Komunën e Vushtrrisë.

1. Elementi i parë - “Qytetarë të informuar”

Komuna e Vushtrrisë është një komunë urë-lidhëse në mes të regjionit të Mitrovicës dhe Prishtinës. Vushtrria është një vend i pasur me trashëgimi kulturore dhe historike. Dhënia e informacionit të plotë për qytetarët jo vetëm që krijon një qeverisje të mirë dhe të hapur por edhe rrit vlerat e këtij qyteti për qytetarët dhe vizitorët e tij.

Indikatorët: Numri i mekanizmave për informim brenda komunës; numri i lajmeve të publikuara gjatë vitit; numri i broshurave; buletineve të publikuara; numri i shpalljeve/materialeve të publikuara në tabelat informuese dhe përqindja e qytetarëve që janë të kënaqur me informimin nga ana e komunës.

2. Elementi i dytë - “komunikues”

Komuna e Vushtrrisë është një institucion i hapur për të gjithë. Marrja e mendimit të qytetarëve pa dallim gjinie, feje dhe etnie për vendimet të cilat ndikojnë në jetën e tyre, është thelbësore për qeverisjen komunale.

Indikatorët: Numri i takimeve publik; numri i dëgjimeve publike; numri i qytetarëve që marrin pjesë në takime dhe dëgjime publike; numri i qytetarëve të pranuar për takime individuale dhe numri i kërkesave të qytetarëve të shqyrtuara nga komuna.

3. Elementi i tretë - “pjesëmarrës aktiv”

Vushtrria ka një traditë të qytetarisë aktive, andaj iniciativat e qytetarëve të cilët janë aktiv në dhënien e opinionit të tyre janë thelbësore për avancimin e demokracisë.

Indikatorët: Numri i iniciativave të qytetarëve; numri i aplikacioneve që dorëzohen në komunë nga qytetarë; numri i iniciativave të mbështetura nga komuna dhe numri i qytetarëve që kanë përfituar nga këto iniciativa.

4. Elementi i katërt- “përmirësimi i kualitetit të jetës”

Komuna e Vushtrrisë në 13 vitet e qeverisjes lokale ka punuar në përmirësim të kualitetit të jetës së qytetarëve. Megjithatë, iniciativat e qytetarëve të cilët identifikojnë hapësirat dhe mundësitë për përmirësim, ndihmojnë në qëndrueshmërinë e kualitetit të jetës.

Indikatorët: Numri i projekteve të realizuara; mjetet e alokuara për mbështetje të iniciativave të qytetarëve nga komuna dhe përqindja e qytetarëve të kënaqur me kualitetin e jetës.

4.1 KEMA - Strategjia për informim, komunikim dhe pjesëmarrje të qytetarëve, ka për vizionin tri objektiva kryesore dhe 11 prioritetë:

Komuna e Vushtrrisë në periudhë tre vjeçare të ketë qytetarë të informuar, komunikues dhe pjesëmarrës aktiv me qëllim të përmirësimit të kualitetit të jetës.




Fig.2. Skema e strategjisë

V. OBJEKTIVAT DHE PROJEKTET

Strategjia për informim, komunikim dhe pjesëmarrje të qytetarëve, ka tri objektiva kryesore:

5.1 OBJEKTIVA 1: AVANCIMI I OFRIMIT TË INFORMACIONIT PUBLIK PËR QYTETARËT

Përmes kësaj objektivë, Komuna e Vushtrrisë synon të avancojë ofrimin e informacioneve për qytetarët për punën e Administratës Komunale, përkatësisht drejtorive, në planet, arrijtjet dhe shërbimet të cilat ofrojnë duke bërë publikimin e formularëve online, mënyrë e cila u mundëson lehtësim qytetarëve në qasjen e shërbimeve publike. Në të njëjtën kohë, po ashtu do të publikohen informacione mbi punën e Kuvendit Komunal, përmes publikimit të informacioneve mbi punën e kuvendit dhe komiteteve të tij.

OBJEKTIVA STRATEGJIKE	PRIORITETI	MASAT
Objektiva 1: Avancimi i ofrimit të informacionit publik për qytetarët, mbi punën e Komunës së Vushtrrisë	Prioriteti 1: Komunikim efektiv brenda komunës me qëllim të ofrimit të informacionit me të plotë tek qytetarët;	Masa 1: Drejtoritë komunale, kuvendi dhe komitetet e tij të ofrojnë informacione për shërbime komunale tek ZKP, në mënyrë që ato të publikohen në ueb faqe të komunës (shërbimet e ofruara dhe aplikacionet online);
		Masa 2: Drejtoritë komunale të ofrojnë informacione tek ZKP mbi iniciativat/aktivitetet, sidomos ato që ndërlidhen me fushën e buxhetit dhe financave, administratës, arsimit, shëndetësisë ,investimeve kapitale dhe zhvillimit ekonomik;
		Masa 3: Drejtoritë komunale të ofrojnë storje të suksesit tek ZKP, në mënyrë që qytetarët të informohen mbi të arriturat e komunës;
		Masa 4: Publikimi i storiëve mbi sukseset dhe kontributin e diasporës së Vushtrrisë;
		Masa 5: Ngritja e kapaciteteve të ZKP;
	Prioriteti 2: Shfrytëzim efektiv i mekanizmave ekzistues të informimit me qëllim të dhënies së informacionit për qytetarë;	Masa 1: Kontinuiteti i mirëmbajtjes së ueb faqes komunale;
		Masa 2: Përdorim efektiv i rrjeteve sociale në ofrimin e informacionit për publikun;
		Masa 3: Publikim i informacioneve ne tabela informuese;
		Masa 4: Publikimi i broshurave, fletëpalosjeve dhe panove;
	Prioriteti 3: Krijimi i mekanizmave të rinj për dhënien e informacionit;	Masa 1: Krijimi i kalendarit vjetor për aktivitetet e planifikuara komunale;
		Masa 2: Krijimi i linjës telefonike ndihmëse për qytetarë;
